



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2023:239535

Datë: 24.09.2024

Numri i dokumentit: 06199669

C.nr.3799/23

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtarja Edije Sezairi, me praktikantin R.S. në çështjen juridike kontestimore të paditëses A.K. me nr. personal nga Prizreni, të cilen me autorizim e përfaqëson av. A.H. nga Prishtina, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit Drejtoria Komunale e Arsimit, me objekt të kontestit kompensimin e diferencës së pagës së kualifikimit të pa paguara, vlera e kontestit 1000 euro, jashtë seancës, më datë 23.09.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. **APROVOHET** pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditëses A.K. nga Prizreni,
- II. **DETYROHET** e paditura Komuna e Prizrenit-Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditëses në emër të kompensimit të të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit, për periudhën kohore prej datës 02.11.2020 deri më datë 02.11.2023 apo për 24 muaj (për çdo muaj shumë prej 55.35 euro, në shkallë prej 27 % të pagës bazë 421 euro, t'ia paguajë shumë e përgjithshme prej 1273.05 euro, me kamatë ligjore prej 8% nga dita e parashtrimit të padisë me datë 02.11.2023, e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përbarimit të detyrueshëm.
- III. **REFUZOHET** pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditëses, përtej shumës së gjykuar sikur në pikën II të këtij dispozitivi apo në shumë prej 110.7 euro. si e pa bazuar.
- IV. **DETYROHET** e paditura, që paditëses, t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 134.00 euro, në afat prej 7 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përbarimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Paditësja A.K. nga Prizreni, të cilen me autorizim e përfaqëson av. A.H. nga Prishtina, pranë kësaj gjykate me datën 02.11.2023, ka parashtruar padi kundër të paditurës Komuna e Prizrenit Drejtoria Komunale e Arsimit, me objekt kontesti kompensimin e diferencës së pagës në bazë të kualifikimit të pa paguara, nga data 01.10.2020 deri me datën 30.10.2022, çdo muaj shumë prej 55,35 euro apo shumë e përgjithshme prej 1.383.75 euro.

Në referatin e padisë ka theksuar se paditësja është në marrëdhënie pune në shkollën "Lekë Dukagjini" si mësimdhënëse. Meqenëse paditësja është e licencuar dhe e kualifikuar

mësimdhënës e me titull të përgaditjes së lartë shkollore , bazuar në nenin 3 dhe 4 të Vendimit të Qeverisë së Kosovës nr.01/33, të datës 29.08.2008, është paraparë ngritja e pagave për mësimdhënësit, drejtorët, bashkëpunëtorët profesional në nivelin Parashkollor dhe atë të mesëm, dhe atë me diplomë të shkollës së normale prej 10%, me diplomë të shkollës së lartë pedagogjike prej 19%, me diplomë universitare 3 dhe 4 prej 27% dhe me diplomë master dhe doktoraturë prej 35%. Nga të lartcekurat paditësja në bazë të kontratës së punës, realizon pagë bazë 421 euro, ndërsa shtesën prej 27% e kësaj page apo shuma prej 113.67 euro e paditura ia paguan pjesërisht në shumën prej 58.32 euro duke i mbetur borxh në shumën 55,32 euro,. Andaj, i ka propozuar gjykatës që të aprovohet padia e paditëses në shumën prej 1,428.84 euro nga data 01.10.2020 deri me datën 01.02.2023, për 28 muaj. Pasi që e paditura nuk e ka përmbushur kërkesën e paditëses vullnetarisht, gjykatës i ka propozuar që të merr aktgjykim dhe ta aprovojë kërkesëpadinë në tërësi si të bazuar. Shpenzimet e procedurës kontestimore i ka kërkuar.

Me anë të parashtrësës së paditësit mbi precizimin dhe plotësimin e padisë, paditësja e ka njoftuar gjykatën se e ka zvogluar kërkesën në aspektin objektiv dhe atë tërhiqen pjesërisht nga një pjesë e kërkesëpadisë sa i përket periudhës kohore nga data 01.11.2022 deri më datën 30.01.2023, dhe se më tutje periudha kohore për të cilën paditësi kërkon kompensimin e diferencës së kualifikimit të papaguar në pagë është nga data 01.10.2020 deri me datë 30.10.2022. shpanzimet e procedurës i ka kërkuar në shumën prej 238.00 euro.

E paditura Komuna e Prizrenit Drejtoria Komunale e Arsimit, përmes të autorizuarit të saj, në këtë gjykatë ka paraqitur përgjigje në padi me datë 27.10.2022, ku ka theksuar se pretendimet e paditëses se i takon kompensimi deri më 18.04.2017, janë ta pabazuara për arsye se në Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës nr.214/2023 e datës 05.10.2023, rastet e të punësuarve që kanë të bëjnë me realizimin e të drejtave që dalin nga Kontrata Kolektive e Arsimit, duhet trajtuar deri me datë 21.11.2022, kur kjo kontratë është shkëputur nga njëra prej palëve kontraktuese. Po ashtu ka theksuar se në bazë të njoftimit të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit nr.01B/ të datës 21.11.2022, për shkëputjen e Kontratës Kolektive të Arsimit të datës 22.01.2021 padia dhe kërkesëpadija e paditëses është e pa bazuar. Pretendimet e paditëses se i takon kompensimi i inflacionit është në kundërshtim me nenin 2 paragrafi 1.1 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, sepse në këtë dispozitë shkruan qartë se përfitues të të gjitha beneficioneve që rrjedhin nga Kontrata Kolektive e Arsimit janë vetëm anëtarët e Sindikatës së Arsimit-SBASHK-ut. Paditësja ushtron padi në gjykatë për realizimin e të drejtave të saj pa përfunduar procedura administrative, sepse nuk i ka vazhduar procedurat në Inspektoratin e Punës në Prizren. Padia është në kundërshtim të plotë me nenin 56 të Ligjit të Punës, sepse me këtë dispozitë parashihet decidivisht se çka përfshinë paga shtesë. Andaj, çështja e pagës shtesë për shkak të inflacionit siç pretendojnë paditëses nuk lejohet me ligjin e punës, i cili ligj në këtë rast është ligj i veçantë dhe e rregullon çështjen e pagës shtesë dhe rrjedhimisht ligji i veçantë në çdo çështje ka epërsi kundrejt çdo ligji apo akti nënligjor. Pretendimet e paditëses se i takon beneficioni nga Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë, janë në kundërshtim me nenin 90 paragrafët 1.1 dhe 1.2 të Ligjit të Punës të R. Kosovës Nr.03/L-212, sepse sipas këtyre dispozitave marrëveshja kolektive lidhet në mes të organizatës së punëdhënësve dhe organizatës së të punësuarve, ndërsa në këtë rast Komuna e Prizrenit është punëdhënësi dhe nuk mund të obligohet në përmbushjen e kësaj kontrate, pa qenë palë nënshkruese e kësaj kontrate. Po ashtu konsideron se e drejta për kompensim për kualifikim e vitit 2017 deri më 18.04.2021 është parashkruar, sipas nenit 535 të LMD. Në fund gjykatës i ka propozuar që padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses ta refuzoj në tërësi si të pabazuara. Shpenzimet e procedurës kontestimore nuk i ka kërkuar.

Po ashtu konsideron se e drejta për kompensimin e inflacionit prej vitit 2020, është parashkruar, sipas nenit 353 të LMD, sepse kanë kaluar mbi 3 vite.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 398 dhe 399 të LPK-së, gjeti se kërkesëpadia e paditësit është pjesërisht e bazuar, andaj pa shqyrtim të çështjes, e aprovoi kërkesëpadinë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Ndërmjet palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestues fakti se paditësja A.K. nga Prizreni, është në marrëdhënie pune tek e paditura shkollën “Lekë Dukagjini”, si mësimdhënëse. Mirëpo, kontestuese ishte nëse paditëses i takon e drejta e kompensimit të të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit për periudhën 01.10.2020 deri më 30.10.2022, përkatësisht diferencës konkrete të papaguar, si dhe nëse kërkesa e paditëses për kompensimin e të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit është parashkruar dhe se kërresa e tillë e parashtruar për periudhën 01.10.2020 deri më 30.10.2022, përbën objekt të parashkrimit.

Në këtë drejtim, gjykata nga kontrata e punës me numër 1, të datës 30.10.2015, e lidhur ndërmjet paditëses dhe të paditurës, rezulton se paditësja është e punësuar tek e paditura si mësimdhënëse nga data 28.10.2015. Paditësja ka diplomuar me datë 14.06.2011 dhe ka marr titullin e kualifikimit universitars Baçellor, arsimtar i mësimit klasor dhe ka licencë të mësimdhënësit. Bazuar në listën e pagave të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës, vërtetohet se lartësia e pagës bazë të paditëses është në shumë prej 421 euro dhe se paditëses në emër të kualifikimit, në pagën bazë i është paguar pjesërisht shuma prej 58.32 euro duke i mbetur borxh 55.35 euro nuk i është paguar fare.

Provat e lartcekura, gjykata i pranoi si prova materiale vendimtare, në kuptim të nenit 329 par. 1 të LPK-së, sipas së cilës dispozitë ligjore përcaktohet se *“shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”*. Andaj meqë këto dokumente janë të pranueshme edhe për vetë palën e paditur, pasi që të njëjtat nuk janë kontestuar, gjykata ia fali besimin e plotë.

Gjykata gjen se në rastin në fjalë zbatohen dispozitat e Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr.01/33 të datës 29.08.2008. Kështu, në pikën 1. të këtij vendimi, përcaktohet që *“nga 1 shtatori 2008 të gjithë mësimdhënësit, drejtorët (zëvendësdrejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesional në shkollat e Republikës së Kosovës, do të kenë rritje të pagave të tyre në bazë të kriterëve të licencimit”*. Ndërsa, në pikën 4. të vendimit në fjalë parashihet ngritja e pagës sipas shkallës apo nivelit të kualifikimit ose licencimit, në të cilën përcaktohet se *“mësimdhënësit, drejtorët (zëvendësdrejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesional, të pajisur: 1). Me diplomë të Shkollës Normale përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 10%; 2). Me diplomë të Shkollës së Lartë Pedagogjike përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 19%; 3). Me diplomë universitare 3 dhe 4 vjet përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 27% dhe 4). Me diplomë të ciklit të dytë dhe të tretë (Magjistraturë dhe Doktoraturë) përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 35%”*. Pastaj, bazuar në mendimin juridik të Gjykatës Supreme nr. 214/2023 të datës 09.10.2023, në pikën I. të tij përcaktohet që *“për kërkesat e mësimdhënësve për kompensim mbi bazën e kualifikimit (licencimit), kompensimi bëhet sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara me Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr.01/33, datë 29.08.2008”*, vendim i cili ka qenë në fuqi deri më 06.02.2023.

Në rastin konkret, gjykata gjeti se e paditura ka për detyrim, që paditëses t'ia paguaj kompensimin mbi bazën e kualifikimit ose licencimit, konform detyrimeve që rrjedhin nga Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr.01/33, datë 29.08.2008, sipas shkallës apo nivelit të kualifikimit ose licencimit të përcaktuar në këtë vendim. Më konkretisht, nga lista e pagave të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës, rezulton se e paditura, në emër të kualifikimit apo licencimit në pagën bazë, ia ka paguar shumën prej 28.32 euro. Sipas pikës 4 nën pikës 3 të Vendimit nr.01/33 të datës 29.08.2008, paditësja përfiton ngritje prej 27 % të pagës bazë, që në rastin konkret paditësja përfiton ngritje në pagën bazë në shumën prej 113.67 euro, në emër të licencimit apo kualifikimit, pra meqenëse e paditura i'a paguan pjesërisht shumën prej 58.32 euro, të njëjtës i ka mbetur pa paguar shuma prej 55,35 euro. Andaj, gjykata vendosi si në pikën nën II. të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke e detyruar të paditurën që paditëses për çdo muaj t'ia paguaj shumën prej 55.35 euro apo diferencën e mbetur për 23 muaj, nga data 02.11.2020 e deri më datë 30.10.2022, në shumë të përgjithshme prej 1273,05 euro ($23 \times 55.35 = 1273.05$) euro.

Bazuar në të lartcekurat, gjykata vendosi duke iu referuar nenit 398 të LPK-së, ku parashihet që: *“Kur gjykata, pasi t'i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”*, Po ashtu, gjykata vendosi jashtë seancës gjyqësore edhe në kuptim të nenit 399 par. 1 të LPK-së, pasi që pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditëses është e pabazuar në dispozita ligjore. Në këtë drejtim, sipas nenit 399 par. 1 të LPK-së parashihet që *“kur gjykata, pasi t'i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga 7 faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do të jep vendimin meritor me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia”*.

Në anën tjetër sa i përket pjesës refuzuese, gjykata vlerësoi se paditësja në padinë e saj ka pretenduar se i takojnë kompensimet në emër të kualifikimit nga data 01.10.2020 deri më 30.10.2022 gjithsej 23 muaj punë, ndërsa padinë pranë kësaj gjykate e ka dorëzuar më 02.11.2023. Gjykata duke marrë parasysh nenin 353 të LMD ka arritur në gjetjet se periudha nga 01.10.2020 deri me 01.11.2020 është parashkruar dhe si e tillë është refuzuar, duke mbetur vetëm periudha kohore nga data 02.11.2020 deri me datë 30.10.2022, respektivisht 23 muaj. Të njëjtës nga kërkesa e saj i'u minusua nga shuma e përgjithshme 110.7 euro

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse dhe duke llogaritur kamatën ligjore si në dispozitiv, bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashtrimit të padisë në këtë gjykatë (06.11.2023), bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditur është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse.

Lidhur me kundërshtimet tjera të palës së paditur dhënë në përgjigje në padi, gjykata vlerësoi se të njëjtat nuk janë të bazuara në dispozita ligjore dhe nuk kanë mbështetje në ndonjë bazë faktike apo juridike. Rrjedhimisht, gjykata erdhi në përfundim se faktet nuk ishin kontestuese dhe nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e vendimit meritor.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është marrë konform nenit 449 dhe 453 të LPK-së lidhur me nenin 463 par.1 të LPK-së, duke obliguar të paditurën që në emër të shpenzimeve të

Numri i lëndës: 2023:239535

Datë: 24.09.2024

Numri i dokumentit: 06199669

procedurës kontestimore, paditëses t'ia paguajë shumën e përgjithshme prej 134.00 euro, sipas Tarifës së Odës së Avokatëve, për përpilimin e padisë shumën prej 104.00 euro dhe për taksë gjyqësore shumën prej 30.00 euro.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me nenin 398 dhe 399 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE PRIZREN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM DIVIZIONI CIVIL
C.nr.3799/23 me datë 23.09.2024

Gjyqtarja
Edije Sezairi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimin të të njëjtit, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.